

PROJEKTMAREVESHJE PER BASHKIMIN E SHOQERIVE

Ne Elbasan sot me date 26.04.2016, ne seline e shoqerise „ERGI PINK“ shpk qe ndodhet ne Bradashesh ish Uzina 12, godina 1 kateshe, Elbasan hartohet ky projekt per bashkimin e kesaj shoqerie me shoqerine „ELIVA“ shpk.

Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes te njeres shoqeri nga nje shoqeri egzistuese.

1. Drejtimi i bashkimit

a. Shoqeria perthithese:

„Ergi Pink“ shpk NIPT L12710202A.

Kapitali i regjistruar 100.000 leke

Ortaku i vetem: Sadik Pisha.

Selia: Bradashesh ish Uzina 12, godina 1 kateshe, Elbasan

b. Shoqeri e perthitur:

„Eliva“ shpk. NIPT K53009202C.

Kapitali i regjistruar 100.000 leke

Ortaku i vetem: Sadik Pisha.

Selia: Bradashesh, Fshati Kusarth, Elbasan.

2. Motivet dhe qellimi i bashkimit.

Qellimi dhe motivi i bashkimit eshte menaxhimi me i mire i aktivitetit ekonomik e financiar, perdorimi me me shume efektivitet i mjeteve financiare, zgjerimi i aktivitetit nepermjet perthithjes se aktivitetit te Shoqerive kontribuse, duke realizuar ne kete menyre shtimin e produktit te ri, perballimin e konkurences ne treg dhe per rrjedhoje rezultate me te mira te fitimit. Ja kush do te jene aspektet kryesore te ketij bashkimi:

- Shoqeria perfituese e kontributeve ose Shoqeria perthithese ne perfundim te ketij procesi do te ruaje emrin Shoqeria „Ergi-Pink“ shpk.
- Selia e Shoqerise perfituese te kontributeve do te jete ne Bradashesh ish Uzina 12, godina 1 kateshe, Elbasan .
- Te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise te perthitur, „Eliva“ shpk. mbas perfundimit te operacionit do ti kalojne Shoqerise perthithese „Ergi-Pink“ shpk.
- Shoqeria e perthitur, „Eliva“ shpk. si shoqeri e perthitur nga shoqeria „Ergi-Pink“ shpk ne perfundim te ketij operacioni do te priset pa likuidim duke kaluar plotesisht trashegimine e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek shoqeria perthithese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit.
- Data 31 maj 2016 do te quhet sipas Ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare“, ne aspektin e kontabilitetit si data e bashkimit te shoqerive.
- Data 31 maj 2016, eshte data ne te cilen jane hartuar pasqyrat financiare per efekt te bashkimit, dhe qe do te perdoren per kete qellim.

3. Aktivitet dhe pasivet e parashikuara per tu bashkuar

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi parashikohet qe shoqeria „Eliva“ shpk si shoqeri e perthitur, ti transferoje (kaloje) shoqerise „Ergi-Pink“ shpk si shoqeri perthithese, teresine e elementeve te aktivitetit dhe te pasivit ashtu si rezultojne ne bilancin e dates 31.05.2016. Elementet e

aktivitet dhe te pasqyrit qe do te kalojne nga shoqerite e perthithura ne shoqerine perthithese paraqiten ne pasqyren nr.1

Ne kete tabele paraqitet dhe bilanci i perbashket dhe mbas realizimit te operacionit te bashkimit .

4. Modalitetet dhe raportet e kembimit te aksioneve .

Te dy shoqerite e perfshira ne kete proces bashkimi jane nen kontroll te perbashket, mbasi kuotat e te dy shoqerive pjesmarrese ne kete bashkim, si shoqeria perthithese ashtu edhe shoqeria e perthithur zoterohen 100 % nga i njejti ortak Z. Sadik Pisha. Per kete arsye ne mbeshetje te nenit 225 , pika 2 e Ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", nuk eshte i detyrueshem permbushja i kushteve te tille si pranimi i paleve per kalimin e pasurise te shoqerise qe perthithet, raporti i kembimit te aksioneve dhe kushtet e ndarjes se aksioneve ne shoqerine perthithese.

Nga sa u theksua me siper kuptohet se kemi te bejme me bashkimin e dy shoqerive qe zoterohen nga i njejti ortak. Keto shoqeri nuk kane lidhje kapitali me njera tjetren.

Ne keto kushte perkundrejt kalimit te aktiveve dhe pasiveve ne shoqerine perthithese „Ergi-Pink“ shpk , do te behet zmadhimi i kapitalit te shoqerise perthithese pas bashkimit.

Mbas perfundimit te procedurave te bashkimit do te kemi nje shoqeri te vetme „Ergi-Pink“ shpk .

Kapitali i regjistruar i shoqerise perthithese pas bashkimit do te jete 200.000 leke i perbere nga nje kuote.

Zoterues i kuotes se kapitalit te shoqerise mbas bashkimit eshte z. Sadik Pisha i cili zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.

Shoqeria „Ergi-Pink“ shpk gezon frutet e kontributit te shoqerise „Eliva“ shpk duke filluar nga data e realizimit te bashkimit ne fjale.

Selia e Shoqerise perfituese te kontributeve do te jete ne Bradashesh ish Uzina 12, godina 1 kateshe, Elbasan .

Perfaqesues ligjor i shoqerise do te jete z. Sadik Pisha me afat deri ne daten 31.05.2020.

5. Emerimi i ekspertit

Emerohet si ekspert kontabel per te bere raportin e bashkimit zoti Agim Qenani.

6. Data kontabel

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerive te perthithura do te merren ne librat e shoqerise perthithese nga data 01.01.2016 persa i perket pasqyres te te ardhurave dhe shpenzimeve. Nga ana tjetere regjistrimi i aktiveve dhe pasiveve ne librat e shoqerise perthithese do te behet sipas bilancit te dates 31.05.2016.

7. Te drejtat dhe avantazhe te vecanta

Ky operacion bashkimi nuk do te permbaj as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante .

Ky projekt bashkimi hartohet e nenshtruhet ne kushtin e varesine se miratimit nga asambleje e pergjithshme e jashtezakonshme e sejciles prej shoqerive pjesmarrese pas dates 31.05.2016.

8. Fuksionimi i Shoqerise Perthithese “Ergi-Pink” shpk

Shoqeria „Ergi-Pink“ shpk do te vazhdoje te funksjonoje me Aktin e themelimit dhe Statutin e saj.

Ne objektin e shoqerise nuk do te behet asnje ndryshim.

9. Pasoja per te punesuarit pas bashkimit.

Marrdheniet juridike me te punesuarit e shoqerise te perthithur, (para bashkimit), do te mbarten nga shoqeria perthithese dhe marrdhenia e punes do te vazhdoje rregullisht edhe pas perfundimit te procesit te bashkimit, deri ne perfundim te kontratave te punes te lidhura me te punesuarit.

10. Marrdheniet me te tretet

Marrdheniet juridike te shoqerise se bashkuar me te tretet, (te krijuara para bashkimit), do te mbarten ne shoqerine perthithese dhe detyrimet qe burojne nga keto kontrata do te permbushen nga shoqeria perthithese.

11. Marrdheniet me shtetin

Marrdheniet juridike te shoqerise se bashkuar me shtetin, (te krijuara para bashkimit), do te mbarten ne shoqerine perthithese dhe detyrimet qe do te rezultojne per shoqerite e perthithura deri ne mbarimin e tyre si person juridik do te permbushen nga shoqeria perthithese.

Per shoqerine „Ergi-Pink“ shpk

Administratori

Sadik Pisha



Per shoqerine „Eliva“ shpk

Administratori

Sadik Pisha



RAPORT I ADMINISTRATOREVE

Per shpjegimin e projektit te bashkimit

Sot me date 26.04.2016, Z. Sadik Pisha administrator i shoqerise „Ergi –Pink“ shpk dhe njekohesisht administrator i shoqerise „Eliva“ shpk, pergatit kete raport te hollesishem per shpjegimin e marrveshjes se bashkimit te shoqerive „Ergi-Pink“ shpk dhe „Eliva“ shpk, te dyja shoqeri te zoteruara 100% prej ortakut te vetem Z. Sadik Pisha.

Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes te dy shoqerive nga nje shoqeri egzistuese.

1. Informacion per shoqerite qe do te bashkohen:

- a. Shoqeria „Ergi-Pink“ shpk me NIPT L12710202A, me kapital te regjistruar ne shumen 100.000 leke, me ortak te vetem z. Sadik Pisha, i cili zoteron 100% te kapitalit te shoqerise, dhe me seli ne Bradashesh ish Uzina 12, godina 1 kateshe, Elbasan, e cila do te jete shoqeria perthithese.
- b. Shoqeria „Eliva“ shpk me NIPT K53009202C, me kapital te regjistruar prej 100.000 leke, me aksioner te vetem z. Sadik Pisha, i cili zoteron 100% te pjeseve te shoqerise, dhe me seli ne Bradashesh, Fshati Kusarth, Elbasan, e cila do te jete shoqeria e perthithur.

2. Baza ligjore e raportit.

Baza ligjore dhe dokumentacioni mbi bazen e te cilit eshte pergatitur ky raport eshte si me poshte:

- Bilanci kontabel dhe pasqyrat financiare te shoqerive te perfshira ne kete proces bashkimi te vitit ushtrimor 2016 i mbyllur me date 31.05.2016.
- Librat kontabel.
- Inventaret e gjendjes fizike.
- Aktet e themelimit te dy shoqerive te perfshira ne kete proces bashkimi.
- Statutet e dy shoqerive te perfshira ne kete proces bashkimi.
- Ligji nr 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.
- Ligji nr 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- Standartet Kombetare te Kontabilitetit.
- Bilancet dhe raportet e ecurise se veprimtarise te dy shoqerive per tre vitet e fundit.

3. Aktivitet qarkulluese

Ne aktivet qarkulluese te shoqerise perthithese pas bashkimit do te perfshihen gjendjet e inventareve, gjendjet e kerkesave per arketim ndaj te treteve dhe gjendja e likuiditeteve te dy shoqerive me date 31.05.2016.

4. Aktivet afatgjata.

Aktivitet afatgjata do te inventarizohen sipas vlerave qe kane ato ne kontabilitetin e sejciles shoqeri, duke marre per baze inventarin fizik dhe kontabel te dates 31.05.2016. E gjithje vlere e aktiveve afatgjata te shoqerive te perthithura do ti kaloje shoqerise perthithese.

5. Kapitalet e veta

Perkunderjt kalimit te aktiveve neto ne shoqerine perthithese „Ergi-Pink“ shpk, ne bilancin e shoqerise pas bashkimit do te emetohet kapital i ri nga kjo shoqeri ne masen 100.000 leke, kapital i

cili i kalon ortakut te shoqerise se perthithur "Eliva" shpk, perkundrejt eleminimit te pjeseve te kapitalit te shoqerise se perthithur.

Kapitali i regjistruar i shoqerise perthithese pas bashkimit do te jete 200.000 leke, e ndare ne nje kuote me vlere nominale 200.000 leke.

Zoterues i kuotes se kapitalit te shoqerise mbas bashkimit eshte z. Sadik Pisha i cili zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.

6. Detyrimet kreditore.

Marrdheniet juridike te shoqerise se bashkuar me te tretet, (te krijuara para bashkimit), do te mbarten ne shoqerine perthithese dhe detyrimet qe burojne nga keto kontrata do te permbushen nga shoqeria perthithese.

7. Regjistrimet kontabile tek shoqeria perthithese.

Data e ngurtesimit, (data e references), te llogarive per bashkimin eshte data 31.05.2016.

Regjistrimet ne librat e kontabilitetit pas bashkimit do te behen duke pasqyruar operacionin e bashkimit nepermjet kalimit te aktiveve dhe detyrimeve nga shoqeria e perthithur tek shoqeria perthithese si me poshte:

- a. Kalimi i aktiveve dhe detyrimeve nga shoqeria e perthithur tek shoqeria perthithese do te behet duke kaluar te gjitha elementet e aktivitetit dhe te pasivitetit dhe duke regjistruar teresisht kalimin e pronesise mbi keto aktive dhe detyrime tek shoqeria perthithese.
- b. Sic eshte parashikuar edhe ne projektin e marrveshjes se bashkimit, shoqeria perthithese merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise te perthithur.
- c. Gjendja e kapitalit te regjistruar dhe zoterimi i aksioneve ne shoqerine perthithese pas bashkimit do te jete nje kuote me vlere nominale 200.000 leke , dhe do te zoterohet 100% nga ortaku i vetem z. Sadik Pisha.

Per shoqerine „Ergi-Pink“ shpk
Administratori



Per shoqerine „Eliva“ shpk
Administratori

Sadik Pisha



**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ERGI-PINK" SH.P.K.**

Sot me 26.04.2016, mbahet ne seline e shoqerise "Ergi-Pink" sh.p.k. adrese Bradashesh, ish Uzina 12, godina 1 katshe, Elbasan, asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie, per te vendosur sa me poshte:

RENDI I DITES

1. Miratimi i bashkimit me perthithje te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Ergi-Pink" sh.p.k. shoqeri perthithese me shoqerine "Eliva" sh.p.k." sh.a. shoqeri e perthithur.
2. Miratimi i Projektmarrveshjes se bashkimit te shoqerive te hartuar nga administratoret e shoqerive respektive
3. Miratimi i relacionit te administratoreve.
4. Miratimi i raportit te ekspertit kontabel per bashkimin.
5. Miratimi i aksionerit te shoqerise se bashkuar.

Eshte i pranishem Z. Sadik Pisha, ortak i vetem e shoqerise "Ergi-Pink" sh.p.k. dhe qe zoteron 100% (njeqind per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Sadik Pisha, mbasi shqyrton dokumentacionin perkates te hartuar nga administratoret e shoqerive pjesmarrese ne bashkim, sic jane Marrveshja e bashkimit, Raporti i eksperteve dhe Raporti i administratoreve, konstaton se jane ne perputhje me vullnetin e saj.

Ne perfundim te shqyrtimit ortakja e vetme

VENDOSI

1. Te miratoje bashkimin me perthithje te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Ergi-Pink" sh.p.k. shoqeri perthithese me shoqerine "Eliva" sh.p.k." si shoqeri e perthithur.
2. Te miratoje Marrveshjen e bashkimit te shoqerive te hartuar nga administratoret e shoqerive respektive.
3. Te miratoje relacionin e administratoreve.
4. Te miratoje raportin e ekspertit kontabel per bashkimin.
5. Miratimi i aksionerit te shoqerise se bashkuar qe eshte Z. Sadik Pisha.

Duke mos patur asgje tjeter mbi te cilen te vendosej asambleja deklarohet e mbyllur.

Kete proces-verbal te pergatitur ne tre kopje ortaku i vetem e aprovon dhe e nenshkruan si me poshte:

Ortaku i vetem

Sadik Pisha



**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ELIVA" SH.P.K.**

Sot me 26.04.2016, mbahet ne seline e shoqerise "ELIVA" sh.p.k. adrese Bradashesh, Fshati Kusarth, Elbasan, asambleja e ortakeve te kesaj shoqerise, per te vendosur sa me poshte:

RENDI I DITES

1. Miratimi i bashkimit me perthithje te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Eliva" sh.p.k. shoqeri e perthithur me shoqerine "Ergi-Pink" sh.p.k." sh.a. shoqeri perthithese.
2. Miratimi i Projektmarrveshjes se bashkimit te shoqerive te hartuar nga administratoret e shoqerive respektive
3. Miratimi i relacionit te administratoreve.
4. Miratimi i raportit te ekspertit kontabel per bashkimin.
5. Miratimi i aksionerit te shoqerise se bashkuar.

Eshte i pranishem Z. Sadik Pisha, ortak i vetem i shoqerise "Eliva" sh.p.k. dhe qe zoteron 100% (njqind per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Sadik Pisha, mbasi shqyrton dokumentacionin perkates te hartuar nga administratoret e shoqerive pjesmarrese ne bashkim, sic jane Marrveshja e bashkimit, Raporti i eksperteve dhe Raporti i administratoreve, konstaton se jane ne perputhje me vullnetin e tij.

Ne perfundim te shqyrtimit ortaku i vetem

VENDOSI

1. Te miratoje bashkimin me perthithje te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Eliva" sh.p.k. shoqeri e perthithur me shoqerine "Ergi Pink" sh.p.k." si shoqeri perthithese.
2. Te miratoje Marrveshjen e bashkimit te shoqerive te hartuar nga administratoret e shoqerive respektive.
3. Te miratoje relacionin e administratoreve.
4. Te miratoje raportin e ekspertit kontabel per bashkimin.
5. Miratimi i aksionerit te shoqerise se bashkuar qe eshte Z. Sadik Piusa.

Duke mos patur asgje tjeter mbi te cilen te vendosej asambleja deklarohet e mbyllur.

Kete proces-verbal te pergatitur ne tre kopje ortaku i vetem e aprovon dhe e nenshkruan si me poshte:

Ortaku i vetem

Sadik Pisha

**VENDIM I ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE
"ERGI-PINK" SH.P.K.**

Meqenese shoqeria "Ergi-Pink" shpk , ka filluar procedurat e bashkimit me perthithje te saj me shoqerine "Eliva"shpk sot me 20.04.2016, administratori i shoqerise "Ergi-Pink" shpk, vendosi si me poshte:

VENDIM

1. Te emerohet Zoti Agim Qenani, lindur ne Korce me 14.08.1955, banues ne Elbasan, Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "11 Nentori", nr 74, Elbasan, i paisur me licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar nr 53, dhe me leternjoftim nr 028892340, si ekspert kontabel i regjistruar, per te vleresuar kushtet e projektmarveshjes se bashkimit te shoqerise, me shoqerine "Eliva" shpk



**VENDIM I ADMINISTRATORIT TE SHOQERISE
"ELIVA" SH.P.K.**

Meqenese shoqeria "Eliva" shpk , ka filluar procedurat e bashkimit me perthithje te saj me shoqerine "Ergi-Pink"shpk sot me 20.04.2016, administratori i shoqerise "Eliva" shpk, vendosi si me poshte:

VENDIM

1. Te emerohet Zoti Agim Qenani, lindur ne Korce me 14.08.1955, banues ne Elbasan, Lagja "Luigj Gurakuqi", Rruga "11 Nentori", nr 74, Elbasan, i paisur me licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar nr 53, dhe me leternjoftim nr 028892340, si ekspert kontabel i regjistruar, per te vleresuar kushtet e projektmarrveshjes se bashkimit te shoqerise, me shoqerine "Ergi-Pink" shpk

Administratori

Sadik Pjsha

